



Prishtinë: 14.10.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1301\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2055\_05\_20**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **09.10.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 14.10.2020 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa konsumatorit N.Z. (parashtruesi I.P.) nga Komuna e Prishtinës, ndaj vendimit të DMK-së, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2055\_05\_20 i datës 15.05.2020.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09.10.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga I.P. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE si vendim i shkallës së parë, për këto shkaqe: konform Rregullës për kushtet e përgjithshme dhe rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë konsumatori ka parashtruar ankesa te furnizuesi në mënyrë kontinuele nda periudha 08.12.2016 -03.09.2013 për shlyerjen e borxhit komplet dhe shkyçjen nga NQ "Termokos". Konsumatori në ankesë ka theksuar se NQ "Termokos" edhe përkundër shumë ankesave për korrigjimin e gabimeve të tyre, ata veç se kanë konstatuar gjendjen momentale, pra kanë bërë shkelje të nenit 23, pika 3. Konsumatori në ankesë ka theksuar se edhe përkundër kërkesës për shkyçje të datës 08.12.2016 NQ "Termokos" nuk ka bërë asnjë veprim duke kërkuar që të shlyhet i tërë borxhi për tu bërë shkyçja, edhe pse në procesverbalin e datës 24.12.2009 është kërkuar që të ndërpritet faturimi deri në një vendim tjetër.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të konsumatorit konform Rregullës për kushtet e përgjithshme dhe rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë konsumatori ka parashtruar ankesa te furnizuesi në mënyrë kontinuele nga periudha 08.12.2016 - 03.09.2013 për shlyerjen e borxhit komplet dhe shkyçjen nga NQ "Termokos", Bordi i ZRRE-së thekson se është e saktë se konsumatori disa herë nga periudha e lartëcekur ka parashtruar ankesë në NQ "Termokos" dhe se



edhe organi i shkallës së parë në ZRRE (DMK në ZRRE) të njëjtat argumente i ka paraqitur në vendimin e saj, e poashtu edhe përgjigjet e NQ "Termokos" në disa nga ankesat e parashtruar nga konsumatori. Pra sipas Bordit të ZRRE asnjë çështje në këtë rast nuk është kontestuese me konsumatorin.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes edhe përgjigjet e NQ "Termokos", respektivisht përgjigjen e datës 11.01.2017 ku përveç tjerash është theksuar se nga viti 2009 është intervenuar disa herë në nënstacion të atij objekti dhe është evituar defekti, mirëpo edhe përkundër kërkesës së organit të shkallës së parë të ZRRE (DMK në ZRRE) që të sigurohen ato dokumente që dëshmojnë intervenimin, NQ "Termokos" nuk kanë ofruar procesverbalin e tillë.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të konsumatorit se NQ "Termokos" edhe përkundër shumë ankesave për korrigjimin e gabimeve të tyre (nga data e procesverbalit 24.12.2009), ata veç se kanë konstatuar gjendjen momentale, pra kanë bërë shkelje të nenit 23, pika 3, Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë i ZRRE (DMK në ZRRE) në vendimin e tyre e kanë potencuar qartë se bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, konstaton se NQ "Termokos" ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, paragrafi 1 Rregullës për Kushtet e Përgjithshëm të Furnizimit me Energji, pasi ka faturuar konsumatorin edhe përkundër që vet ekipi i NQ "Termokos" në procesverbalin e datës 24.12.2009 ka konstatuar se nuk ka ngrohje, e kjo për shkak të mos-funksionimit të pompës qarkulluese në nënstacion, dhe është rekomanduar që të ndërpritet faturimi. Bordi i ZRRE thekson se edhe në pikë nuk ka asgjë kontestuese me konsumatorin pasi edhe organi i shkallës së parë ka potencuar pothuajse të njëjtat argumente.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të konsumatorit se përkundër kërkesës për shkyçje të datës 08.12.2016 NQ "Termokos" nuk ka bërë asnjë veprim duke kërkuar që të shlyhet i tërë borxhi për tu bërë shkyçja, edhe pse në procesverbalin e datës 24.12.2009 është kërkuar që të ndërpritet faturimi deri në një vendim tjetër, Bordi i ZRRE thekson se sipas nenit 28, paragrafi 1 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshëm të Furnizimit me Energji: *"Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)".* Pra furnizuesi është i obliguar të faturojë konsumatorët për energjinë e shpenzuar, por që në rastin konkret sipas procesverbalit të inspektimit të NQ "Termokos" të datës 24.12.2009 është theksuar se për shkak të defekteve teknike nuk duhet të bëhet faturimi, rrjedhimisht pas kësaj date është dashur të mos faturohet konsumatori nga ajo periudhë, e që me këtë konstatohet se NQ "Termokos" ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, paragrafi 1 i Rregullës së lartëcekur. Pra Bordi i ZRRE thekson se këtë e ke potencuar edhe organi i shkallës së parë i ZRRE në vendimin e saj. Bazuar në këtë, Bordi i ZRRE thekson se pasi që NQ "Termokos" nuk ka vepruar konform dispozitave të lartëcekur dhe mos sigurimin e dokumentit mbi të cilën evidentohen punimet në nënstacion, vendimi i organi të shkallës së parë i ZRRE me të cilën ka vendosur që NQ "Termokos" duhet ta liroj konsumatorin nga faturimi nga periudha 24.12.2009 e deri te periudha 11/2014 (periudha e fillimit të koogjenerimit), është plotësisht i saktë dhe i drejtë. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se i vendimi i organit të shkallës së parë i ZRRE me të cilën ka vendosur që NQ "Termokos" ta rimburosoj konsumatorin për periudhën e lartëcekur, pasi që konsumatori ka bërë pagesën e tërë borxhit të energjisë termike NQ "Termokos" është plotësisht i saktë dhe i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 14.10.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- NQ "Termokos", dhe
- Konsumatorit N.Z. (parashtruesi I.P.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.